



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 64 Prot.

Lezhë, më 27.01.2020

U R D H Ë R

Nr. 08 datë 27.01.2020

**PËR
KRIJIMIN E TASK FORCËS-VENDORE PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBETAR
TË VEPRIMIT KUNDER KULTIVIMIT DHE TRAFIKIMIT TË KANABISIT**

Bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për prefektin e qarkut", neni 8 germa "e", Urdhërin nr.51 datë 13.04.2017 pikat 10, 11 dhe 12 të Kryeministrit, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe koordinuese ndërinstitucionale në nivel qendror dhe vendor, të ngarkuara me përgjegjësinë e zbatimit të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017 – 2020",

U R D H Ë R O J :

- Krijimin e Task – Forcës Vendore (TFV)** për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv në nivel vendor, shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira, hartimin e vlerësimeve të përbashkëta, si dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta në zbatim të detyrimeve të parashikuara në planin e veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017 – 2020 me këtë përbërje:

Prefekti	Kryetar
Perfaqësues i Drejtorisë Vendore të Policisë	anëtar
Perfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gyqësor Lezhë	"
Perfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gyqësor Kurbin	"
Perfaqësues i Drejtorisë Rajonale të SHISH	"
Perfaqësues i Drejtorisë Rajonale të SH S SH	"
Perfaqësues i Degës së Doganës Shëngjin	"
Perfaqësues i Zyrës Vendore Arsimore Lezhë	"
Perfaqësues i NJ V K SH Lezhë	"
Perfaqësues i Agjencisë Rajonale të Ekst. Bujq. Shkodër	"
Perfaqësues i Bashkisë Lezhë	"
Perfaqësues i Bashkisë Kurbin	"
Perfaqësues i Bashkisë Mirditë	"
Perfaqësues i Administratës Rajonale të Z M	"
Perfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve	"
Perfaqësues i Rep. Usht. nr. 1010. B 1 K Vau i Dejës	"
Perfaqësues i I SH M P U T Lezhë	"
Perfaqësues i Drejtorisë Vendore për Kufirin & Migracionin	"
Perfaqësues i Policisë Ushtarake SPU (Shkodër)	"

Task – Forca Vendore të marrë masa për:

1. Administrimin dhe monitorimin e planeve të veprimit të strukturave të përfshira në TFV.
2. Titullarët e institucioneve të përfaqësuara në Task – Forcën Vendore, të paraqesin emrat e anëtarëve perkatës tek prefekti.
3. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të bashkive në task – forcën vendore të rregullohet me marrëveshje ndërmjet prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive perkatëse.
4. Strukturat e perbashkëta të task – forcës vendore të hartojnë dhe të paraqesin në strukturat eprore dhe të titullarët e institucioneve të përfshira, raporte të integruara mujore si dhe vlerësime të veçanta rreth të gjitha masave të parashikuara nga plani i veprimit.
5. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve të përfshira në këtë task - forcë për zbatimin me perpikmëri të këtij urdhëri, sipas planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe grafikut të shkeljes së territorit
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Gjokë JAKU

